



FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË TRYEZËN E SHOQËRISË CIVILE ME PËRFAQËSUESEN E POSAÇME TË KRYETARIT TË RADHËS SË OSBE-SË NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

15 tetor 2018

I nderuar Prof. Severino, e nderuar Drejtore e Përgjithshme, të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile, i nderuar ambasador, e nderuar Elsa Ballauri!

Mirë se erdhët! Marr pjesë në këtë takim me interesim të lartë, si dhe me dëshirën për të nxitur organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri që të mësojnë nga e ftuara jonë e shquar sot, Prof. Paola Severino, Përfaqësuesja e parë e Posaçme e Kryetarit të Radhës së OSBE-së në Luftën kundër Korrupsionit.

E dimë të gjithë rëndësinë që ka lufta kundër korrupsionit në Shqipëri, prandaj kjo vizitë është e shumëpritur dhe shumë e rëndësishme për ne.

E përshëndes kontributin e Prof. Severinos në luftën ndërkombëtare kundër korrupsionit, po aq edhe gatishmërinë e saj për të ndarë përvojën dhe ekspertizën e saj me institucionet dhe shoqërinë civile në Shqipëri.

Të gjithë e njohim rolin që Prof. Severino ka luajtur në luftën kundër korrupsionit në Itali, prandaj OSBE-ja është veçanërisht krenare që e kemi me vete në këtë fushë.

Përfitoj nga rasti edhe për të falënderuar ambasadën italiane për organizimin e kësaj vizite, në kuadrin e punës së lavdërueshme të Kryesisë italiane të Radhës të OSBE-së për të çuar përpara kauzën e luftës antikorrupsion.

Sikurse të gjithë e dimë, korrupsioni është murtajë që prek funksionimin e duhur të institucioneve publike në shërbim të qytetarit. Demokracia nuk mund të lulëzojë në shtete kleptokrate. E thënë qartë dhe thjesht.

E di që qeveria e ka përmirësuar kuadrin ligjor dhe institucional në fushën e antikorrupsionit. Kjo është njohur edhe nga organizata ndërkombëtare si Transparency International, gjatë pesë viteve të shkuara. Por, a është bërë mjaftueshëm? Sfidat e mbetura janë ende shumë të mëdha.

Vitin e kaluar, Shqipëria ra me disa vende në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Kjo u përforcua nga një anketë e PNUD-it, që tregoi se njerëzit ishin më të prekur nga korrupsioni në vitin 2017 se sa në 2016-n.

Kohët e fundit diskutimet janë përqendruar në faktin se rreth një e treta e prokurimeve publike bëhen përmes procedurës me negociim dhe pa konkurs. Mund të flasim më shumë lidhur me këtë.

Zinxhiri i organeve antikorrupsion të specializuara, përfshirë organe të parashikuara nga reforma në drejtësi, si prokuroria e posaçme (SPAK) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, ende nuk janë ngritur.

Kjo tregon se nevojiten përpjekje për të fuqishme si nga qeveria, ashtu edhe nga shoqëria civile, dhe prandaj ju kemi ftuar këtu.

Ju mund të keni një kontribut të qenësishëm në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Ju mund të ushtroni trysni. Dua të them se nga përvoja ime (kam punuar këtu si ambasador i Gjermanisë në vitet 2007-2010) jam paksa i zhgënjyer me shoqërinë civile. Ju keni qenë shumë më të zëshëm në të kaluarën. Ende i mbaj mend posterat e protestave të mëdha kundër korrupsionit, që organizoheshin kur mbërrita këtu. Ku janë ato protesta sot? Kjo nuk ka lidhje vetëm me faktin që Shqipëria u përmirësua nga një nivel i ulët prej 2.9 në indeksin e Transparency International kur mbërrita këtu në 2007-n në 3.1 në 2013-n apo në 3.8 tani. Përmirësim ka pasur, e pranoj. Por, sigurisht, nuk është i mjaftueshëm.

Shpresoj që vizita e sotme dhe diskutimi me Prof. Severinon do t'ju frymëzojnë të bëheni më aktivë.

Fund